

PKR.nr.369/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit gjykues, anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtarve Beqir Kalludra dhe Lutfi Shala me bashkëpunatorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.I., për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nënpar 11 të KPRK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/ I nr.490/16 të datës 29.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të dt:04.06.2018, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurorja e shtetit Bukurije Gjonbalaj, përfaqësuesit e palëve të dëmtuara dhe njëherit vet të dëmtuarit E.A.1 dhe S.G., i akuzuari L.I. me mbrojtësen av.A.M.sipas autorizimit, me dt.05.06.2018 mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

L.I. nga i ati B. dhe e ema L., e vajzërisë R., i lindur me ... në D., me vendbanim në fshatin Sh. - B. e D., ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, i gjendjes të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, në paraburgim nga dt:19.11.2017.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me dt: 29.08.2016, rreth orës 11:40 min në P., afër parkut të qytetit, në rrugën “H.J.”, ka privuar nga jeta E.A.2 dhe A.G., ashtu që pasi që paraprakisht për shkak të një mosmarrëveshje rreth një borxhi me të njejtit, të cilin borxh i akuzuari

nuk e ka pranuar për të vetin, të njëjtit një ditë më parë derisa kishte shkuar te shtëpia e tani të ndjerit E.2 ja kishin marrur të dy të ndjerit E.2 dhe A. veturën e cila ishte në pronësi të motrës së tij dhe pas presionave dhe kërcënimeve të vazhdueshme për kthimin e borxhit, në ditën kritike, pas komunikimit telefonik në mes të akuzuarit L. dhe tani të ndjerit E.2, i njëjti bashkë me tani të ndjerin A.G. me motorin të cilin e drejtonte tani i ndjeri A., janë nisur në drejtim të parkut të qytetit, dhe pasi që kanë arritur të parku i qytetit, derisa i akuzuari L. ka qenë duke e kaluar rrugën në drejtim të Parkut të qytetit, të njëjtit me vrull e kanë ndalur motorin dhe tani i ndjeri E.A.2 ka zbritur nga motori dhe furishëm është nisur në drejtim të akuzuarit L., ndërsa që në atë moment i akuzuari L. me dashje që të njëjtit ti privojë nga jeta, ka shtënë në drejtim të tyre me armë zjarri, duke i goditur disa herë nëpër pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast iu ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, shkak i të cilave tani i ndjeri E.A.2 ka vdekur në vendin e ngjarjes, ndërsa tani i ndjeri A.G. në QKUK, -

- me këtë ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nënpar 11 KPRK-së.

SEPSE: Që nga data e pa vërtetuar deri më dt:29.08.2016 e ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit të tipit të panjohur në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët,-

- me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,3,7,17,41,42,43,45,73, dhe neni 80, 83 të KPRK-së, dhe neneve 365 dhe 450 dhe 463 të KPPK-së i shqipton:

Të akuzuarit L.I. për veprën penale: Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.11 KPRK-së DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjet) vite e 6 (gjashtë) muaj.

Për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej një 1 (një) viti,

Konform nenit 80 par.2 të KPRK-së, e dënon me DËNIM UNIK ME BURGIM njëzet (20) vite, e në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 19.11.2017 e tutje.

Konform nenit 39 par.3 në.par.3.2 të ligjit për kompensim të viktimave obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të paguaj nga 50 euro, për tani të ndjerët E.A.2 dhe A.G..

I akuzuari obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 200 € (dyqind) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 367 par.2 dhe 7 të KPPK-së, i vazhdohet paraburgimi derisa aktgjykimi e merr formën e prerë , por jo më shumë se koha e dënimit e shqiptuar në aktgjykim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për krime të rënda, ka ngritë aktakuzë PP/I nr.490/16 të datës 29.11.2017, kundër të akuzuarit L.I. për shkak të veprave penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nënpar 11 KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautoruar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësorë pas leximit të aktakuzës , me rastin e deklaramit të të akuzuarit lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të nenit 326 parg 1 të KPPK-së, i akuzuari L.I. ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për kryerjen e të cilave është akuzuar, mirëpo që gjykata ka vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i njëjti nuk është në përputhje me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së, andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 327 parg 1 nënpar 1.2 të KPPK –së, ka vendosur të vazhdojë me caktimin e shqyrtimit gjyqësor dhe me administrimin e provave.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, prokurorja e shtetit Bukuriye Gjonbalaj në fjalën përfundimtare të dorëzuar në forma të shkruar e të elaboruar gojarisht, fillimisht ka bërë precizimin e aktakuzës ashtu që në rreshtin e dytë, pas fjalëve “me tani të ndjerin E.A.2” ka shtuar “I pandehuri fillimisht e ka thirrë në telefon tani të ndjerin E.2, kinse për të biseduar rreth borxhit...”, ndërsa që pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pandryshuar. Më tutje ka shtuar se gjendja si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar nga të gjitha provat e administruara, siç janë dëshmitë e dëshmitarve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pranimi i vetë të akuzuarit se ka kryer këtë vepër penale, pastaj nga provat materiale siç janë: Raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes, lista e dëshmive, skica e vendit të ngjarjes, fotoalbumi, raportet e autoposisë, CD-videoincizimet, raportet informuese, raporti i ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për forenzikë, raporti plotësues dhe nga provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe njëherit vet i dëmtuari E.A.1, në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar gojarisht ka theksuar se deri sa djali i tij, tani i ndjeri E.2, tani dëshmitari E.3 dhe shoku i tij, tani i ndjeri A. në ditën kritike deri sa kanë qenë duke pirë kafe, tani i akuzuari L. e ka thirrur 3 herë në telefon kinse për të biseduar rreth borxhit që i kishte i njëjti, e që kjo vërteton se tani i akuzuari L. paraprakisht kishte planifikuar vrasjen dhe për këtë edhe e kishte thirrur që të takohet dhe asnjëherë nuk ka qenë i kërcënuar nga tani i ndjeri E.2.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin L. ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe njëherit vet i dëmtuari S.G. në fjalën përfundimtare të dorëzuar ne formë të shkruar e të elaboruar gojarisht ka theksuar se i ndjeri A. nuk ka qenë i përzirë në konflikt mirëpo që i njëjti vetëm e ka dërguar E.2 te parku i qytetit pasi që i njëjti kishte për t'u takuar me tani të akuzuarin L.. Po ashtu ka shtuar se i akuzuari ka qenë i ndihmuar nga personat e tjerë me të cilët edhe ka planifikuar kryerjen e vrasjes dhe se në momentin kritik pasi që ka shtënë në drejtim të të ndjerëve E.2 dhe A., ai përsëri është kthyer në drejtim të tyre dhe ka vazhduar të shtënë në të njëjtit, ndërsa asnjëri nga pretendimet e të akuzuarit nuk qëndrojnë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë dhe ta dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.I. av. A.M. në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar e të elaboruar gojarisht ka theksuar se i mbrojturi i saj që në fillim të procedurës para organeve të hetuesisë ka pranuar se ka kryer veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar e po ashtu këtë pranim e ka konfirmuar edhe në seancën e shqyrtimit fillesatar mirëpo që e njëjta nuk është pranuar, andaj ka kërkuar që ky pranim të vlerësohet si rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit. Më tutje ka shtuar se në këto rrethana pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor janë vërtetuar rrethana kundërthënëse midis të vërtetës reale dhe mënyrës se si rrethanat janë përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe atë sa i përket dëshmisë së dëshmitarës Sh.F. e cila siç vërtetohet nga videoincizimet nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, ndërsa që nga dëshmia e dëshmitarit E.A.3 vërtetohet se ngjarjes në ditën kritike i ka paraprirë një borxh të cilin i mbrojturi i saj është dashur t'ia kthejë në shumë prej 1500 euro e për të cilën të njëjtit i është marrë vetura e që e njëjta është gjetur tek të dëmtuarit. Andaj ka kërkuar që me rastin e shqiptimit të dënimit të merren parasysh rrethanat lehtësuese siç janë rrethanat në të cilat është kryer vepra, mosha e të akuzuarit, kontributi i tani të ndjerëve në gjithë situatën e krijuar që i ka paraprirë ditës kritike dhe ndaj të mbrojturit të saj të zbatojë dispozitat e nenit 73 par 3 të KPRK-së.

I akuzuari L.I. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbeshtet në tëresi fjalën përfundimtare të mbrojtësjes së tij av. A.M..

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjithave së bashku ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, dhe atë dëshmitë e dëshmitarëve/dëmtuarve E.A.1, S.A. dhe S.G., dëshmitarve Sh.F., E.A.3, M.R. dhe E.H. si dhe provat materiale si raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes i dt: 05.09.2016, raporti informues 11.01.2017, raporti plotësues i dt.20.11.2017, raporti informues dt: 15.11.2016, skica e vendit të ngjarjes e dt:29.08.2016, raportet e autopsisë së

dt:05.09.2016 dhe 08.09.2016, fotoalbumet të dt.29.08.2016 dhe 30.08.2016, raporti i ekzaminimit të veturës 21.11.2017, vërtetimi mbi kthimin e sendeve 22.09.2016, listat e dëshmimeve nr.rast.2016-AB-2766 e dt: 05.09.2016 dhe të dt:30.08.2016, raporti i ekspertimit i dt:10.10.2016 dhe CD-videoincizimi i dt.29.08.2016.

Dëshmitari/ i dëmtuari E.A.1– babai i të ndjerit E.A.2, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike derisa ka qenë në punë është kontaktuar përmes telefonit nga djali tij E.3 i cili e ka njoftuar tani i ndjeri E.2 është plagosur dhe gjendet në emergjencë dhe se në momentin kur dëshmitari ka shkuar tani më i ndjeri E.2 kishte ndërruar jetë, ndërsa që E.3 i ka thënë se tani dëshmitarja Sh.F. i kishte treguar se tani i ndjeri A. i ka thënë “tregoj babit S.G. se na vrau L. i Shqipërisë” dhe se me dëshmitarën Sh. janë takuar në spital dhe i ka treguar për ngjarjen. Më tutje dëshmitari ka shtuar se lidhur me tani të akuzuarin L.I. kishte dëgjuar edhe para ditës kritike gjegjësisht një ditë para se të ndodh rasti ka dëgjuar kur tani i ndjeri E.2 i ka thënë nënës së vet “Nënë ma ka lshu një i Shqipërisë karamel, ia kam dhan 1300 euro e tash spo mi jep” dhe se gjatë bisedës e ka kuptuar se si rezultat i kësaj ia kishin marrë veturën tani të akuzuarit L. deri sa tua kthej gjysmën e parave. Po ashtu ka shtuar se lidhur me privimin nga jeta të djalit të tij E.2 ka dëgjuar se I njëjti në ditën kritike ka qenë duke pirë kafe ne restorantin “E.4” me E.3 dhe tani të ndjerin A. dhe me një shokë të tyre me emrin M.R. dhe ndërkohë tani të ndjerin E.2 e ka thirrur i akuzuari L.I. i cili ka pasur nr e tel. ... dhe atë 3 herë dhe më pastaj tani të ndjerit E.2 dhe A. janë nisur me skuter në drejtim të parkut ku edhe ka ndodhur ngjarja.

Dëshmitari/ i dëmtuari S.G. - babai i të ndjerit A.G.në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se lidhur me ngjarjen është njoftuar nga djali i vëllaut të tij B.G. i cili përmes telefonit e ka informuar se tani të ndjerët A. dhe E.2 janë plagosur nga L. i Shqipërisë i cili i ka pasur borxh tani të ndjerit E.2 dhe se i akuzuari L. e ka thirrur të njëjtin për t’ia dhënë parat dhe bashkë me tani të ndjerin janë nisur me skuter dhe kur janë takuar me të akuzuarin i njëjti ka shtënë në drejtim të tyre dhe se një person me emrin Q. i cili është gjendur rastësisht në vendin ku ka ndodhur ngjarja i ka treguar se pasi që është shtënë në tani të ndjerin A. i njëjti është ngritur në këmbë dhe i ka thënë “Axhi Q. marova” dhe i njëjti i ka ndihmuar për të hyrë në veturën e cila i ka dërguar në spital. Po ashtu dëshmitari ka pohuar se sipas të dhënave dhe hulumtimeve që ka bërë tani të akuzuarit i ka ndihmuar një person i tretë ndërsa që vrasjen e ka planifikuar dy ditë para se të ndodh ngjarja në ditën kritike.

Dëshmitari E.A.3 – vëllau i të ndjerit E.A.2 në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike para se me ndodh ngjarja derisa ka qenë duke shkuar në bastore bashkë me tani dëshmitarin M.R., te parku i qytetit është takuar me të akuzuarin L., pikëshrisht në vendin ku më vonë ka ndodhur ngjarja dhe duke ditur se i njëjti i ka borxh një shumë parash prej 1300 euro dhe pasi që të njëjtin e ka njohur në bazë të një foto të tij që kishtë parë më herët e ka ndalur dhe i

është drejtuar me fjalët “A i ke paret që i’a ki borxh E.2 në shumë prej 1300 euro” ndërsa që i akuzuari L. i është përgjigjur “Nuk kam punë me ty, kam punë me E.2” dhe “Mos piskat me na nij të tjerët” dhe kanë vazhduar në bastore ku ka qëndruar 2-3 minuta, pastaj është kthyer në shtëpi. Më tutje ka shtuar se pasi që ka shkuar në shtëpi dhe ka parë që E.2 është zgjuar nga gjumi, bashkë me të njëjtin dhe tani dëshmitarin M. kanë shkuar në kafiterinë “E.4” dhe ndërkohë ka ardhur me motor tani i ndjeri A. dhe deri sa kanë qenë duke qëndruar , tani i akuzuari L. e ka thirrur tani të ndjerin E.2 dhe e ka dëgjuar kur i njëjti i ka thënë “hajde te parku” ndërsa që tani i ndjeri E.2 i është përgjigjur “A po vjen te lokali E.4” ndërsa që i akuzuari L.i i ka thënë “nuk kam me çka me ardhë” dhe këto fjalë ja ka thënë dëshmitarit tani i ndjeri E.2 në momentin kur i njëjti e ka pytur pse nuk po vjen tani i akuzuari L. aty ku ishin duke qëndruar dhe më pastaj tani të ndjerit me motor të A. janë nisur për ta takuar tani të akuzuarin L., ndërsa që dëshmitari bashkë me tani dëshmitarin M.janë nisur në këmbë të shkojnë në drejtim të parkut dhe pas pak minutash është telefonuar nga shoku i tij A.V., është njoftuar përmes telefonit se është plagosur tani i ndjeri E.2. Më tutje ka shtuar se lidhur me borxhin të cilin L. i aka pasur E.2i e ka kuptuar 7 apo 8 ditë më herët, ku E.2 i’a ka dhënë borxh 1300 euro mirëpo ka pasur për obligim t’ia kthejë 1500 në afat prej 7 apo 8 ditë, ndërsa që nëse nuk do të kishte mundësi t’ia kthejë shumën e lartcekur atëherë ka pasur për obligim t’ia jap një veturë të tipit “Peugeot 206” me tabela të Shqipërisë, mirëpo një ditë para ngjarjes kritike E.2 është takuar me L. në afërsi të shtëpisë së tyre dhe të njëjtit ja ka marrë veturën për shkak se L.i nuk i aka kthyer parat që ka pasur obligim, ndërsa që të njëjtit i është dhënë mundësia që ta kthejë vetëm gjysmën e borxhit dhe pastaj do ti kthehej vetura, ndërsa që vetë dëshmitari nuk ka qenë prezent në momentin e marrjes së veturës. Po ashtu ka shtuar se parat të cilat E.2 ia ka dhënë L. kanë qenë të dedikuara për hapjen e një “Call center” ndërsa që prej momentit kur e ka kuptuar se E.2 i ka dhënë para borxh L. është interesuar për faktin se kush është L., ku banon, çfarë veture vozitë dhe me kënd rri. Dëshmitari në vazhdim është ballafaquar me pretendimet e të akuzuarit L. se I njëjti është rrahur nga dëshmitari E.3 dhe është kërcënuar nga I njëjti kur është takuar në ditën kritike “Ose ki me mi dhon paret ose ka me tmyt krejt”, është përgjigjur se kjo nuk është e vërtetë dhe se krejt 2 herë janë takuar dhe atë rasisht dhe se personi me emrin G. është person i panjohur për të dhe se nuk ka dëshuar e as takuar ndonjëherë me të njëjtin.

Dëshmitarja Sh.F. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se edhe në ditën kritike si çdo ditë tjetër i ka dërguar 2 fëmijët e saj tek parku I qytetit dhe dikun rreth orës 10:00 sa ka qenë në park e ka parë një person duke kaluar rrethojën e parkut e që e të njëjtin e ka parë edhe herave tjera, ndërsa që s aka qenë duke e marrur topin e femijëve me të cilin ishin duke luajtur e ka dëgjuar një person rreth moshës ... vjeç duke i thënë dikujt në telefon se për 2 min do të jenë tæk vendi sepse momentalisht jam te furra “R.” ndërsa që personi i cili i ka kaluar rrethojat ka qenë duke qëndruar në afërsi të kontinjerëve të cilët kanë qenë aty dhe ndërkohë derisa dëshmitarja ka

qenë duke e kaluar rrugën pasi që kishte blerë ujë në market, kanë ardhur 2 persona të cilët ishin në një motor me ngjyrë të kuqe dhe ka parë personin (dëshmitarja i referohet gjatë gjithë dëshmisë si i akuzuari) i cili ka shtënë disa herë me armë në drejtim të 2 personave të cilët ishin në motor, ashtu që fillimisht ka shtën dy herë, pasi që dy personat kanë zbritur nga motori, dhe ka dëgjuar kur njëri prej tyre që me vonë e ka kuptuar se ka qenë E.2, i është drejtuar personit me fjalët “të lutem mos shtën me armë”, mirëpo personi me një gjakftohësi sikurse nuk po ndodhë asgjë ka shtën në drejtim të të njejtëve. Më tutje ka shtuar se pasi personi është larguar dhe pasi që e ka parë se nga po shkon i njëjti dhe duke e vërejtur se askush nuk është duke u afruar për t’iu ndihmuar viktimave, e njëjta iu është afruar, e ka ndal një taksidhe bashkë me 2 persona tjerë viktimat i ka vendosur në veturë dhe i ka dërguar në QKUK. Më tutje e njëjta deklaron se rrugës për në emergjencë tani i ndjeri A.G.pasi që e kishte falenderuar për ndihmën, e ka pyetur se a mund të ma jepësh një nr. të telefonit për ti njoftuar familjarët dhe se a e kishte emrin I. apo si quhej personi që iu qëllloi me armë, ndërsa tani i ndjeri A. është përgjigjur se dikush nga parku do ti njoftojë për ngjarjen dhe tregoj babait se na ka vra L. nga Shqipëria. Dëshmitaria edhe pas ballafaqimit me pjesën e deklaratës të dhën në prokurori me dt: 04.07.2017, ku kishte deklaruar se “dy minuta kam ndëgju të shtëna me armë, pesoni i cili ka shtën me armë, para se me shtën me armë e kom pa se ka qenë brenda në park, e kom pa kur ka kcy... edhe pse ata dy ishin të shtrirë në tokë është afru afër dhe për së afërmi ka shtën në drejtim të tyre...” është përgjigjur se ashtu ka deklaruar duke shtuar se personi plumbat e parë i ka shtën përballë tyre por në një distancë më largë, dhe në momentin kur ata dy janë rrëzu nga motori, është afruar dhe për së afërmi në një distancë prej 1 metër ka vazhduar me shtën me armë dhe sipas saj ato të shtëna kanë qenë 5 herë.

Dëshmitari M.R. në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se edhe me dt:29.08.2016 si dhe çdo mëngjes tjetër është takuar me tani dëshmitarin E.A.3 në një nga kafiteritë e parkut të qytetit dhe ndërkohë kanë takuar të akuzuarin L., me të cilën E.3 ka biseduar dhe e ka dëgjuar kur pasi që E.3 e ka pyetur lidhur me një veturë, i akuzuari L. është përgjigjur unë jam marrë vesh me E.2in dhe parat do ia jap atij, e tërë biseda ka zgjatur rreth 2 min, pastaj kanë vazhduar për në kafiterinë “E.4” ku edhe janë takuar me të ndjerët E.2 dhe A. dhe deri sa ishin duke qëndruar në kafiteri E.2 e ka thirrur L. dhe i ka thënë “Hajde se ti kam ba parat”, këto fjalë pasi që E.2 i ka treguar E.3 se çka tha L..Më tutje dëshmitari ka shpjeguar se ka dëgjuar kur E.3 i ka thënë A. “A po ma jep motorrin që të shkoj me E.2 ti marr parat, dhe kthehemi përsëri” ndërsa që A. është përgjigjur “Nuk guxoj me ta jep motorin se nuk është i imi” dhe pastaj tani të ndjerët janë nisur me motorr për të shkuar me i marr parat, ndërsa që dëshmitari bashkë me E.3 pasi që kanë pritur rreth 5 min për tu kthyer te ndjerët E.2 dhe A. janë nisur në drejtim të parkut dhe kur kanë arritur aty kanë parë policinë dhe kanë kuptuar se çka ka ndodhur.

Dëshmitarja/ e dëmtuara S.A. – nëna e tani të ndjerit E.2, në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se lidhur me borxhin të cilin i akuzuari L. ka pasur ndaj E.2 e ka kuptuar një ditë para se të ndodh ngjarja kritike dikun rreth orës 21:00, pasi që kur kanë ardhur nga pushimet bashkë me bashkshortin e saj ku kishin qëndruar nga e hëna deri të dielën, i ndjeri E.2 në prezencë të dëshmitarit E.3 i cili po ashtu nuk e ka ditur për borxhin, i ka thënë “Parat e kompjuterave ia kam dhënë një djalit të Shqipërisë të quajtur L.” ndërsa që dëshmitarja i është drejtuar me fjalët “Me sa men ia ke dhanë” dhe kanë hyrë brenda në shtëpi. Më tutje ka shtuar se tani të akuzuarin L. nuk e ka parë dhe takuar asnjëherë dhe se asnjëherë nuk ka qenë në oborrin e shtëpisë së tyre, ndërsa që edhe pas ballafaqimit me deklaratën e të akuzuarit L., ku ka deklaruar se “Aty ka dal nana e E.2 në ballkon dhe i ka thënë mosni djalin se gjynah, ndërsa që E.2 nanën e vet e ka sha me rob dhe i ka thënë ti nuk i din punët tona”, dëshmitarja është përgjigjur se nuk është e vërtetë pasi që fëmijët e saj kurrë nuk e kanë sha. Po ashtu ka shtuar se nuk ka qenë në dijeni se të akuzuarit L. i është marrë vetura ndonjëherë, se pranë shtëpisë së saj nuk ka parë ndonjë veturë të ndonjë personi të panjofshem mirëpo që pasi që ka ndodhur rasti ka dëgjuar se një veturë i është kthyer motrës së të akuzuarit L., nga familja e saj.

Dëshmitari E.H. në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se dikun rreth një muaji para ngjarjes kritike tani i akuzuari L. i kishte treguar se ka probleme me dy persona në Kosovë, ndërsa që rreth 2 ditë para ngjarjes e ka thirrur i njejtë dhe përsëri i’ a ka shprehur shqetësimin që kishte si rrjedhojë e kërcënimeve që kishte marrur nga personat që i kishin kërkuar para me fajde dhe se ndërkohë është takuar me të njëjtit tani të ndjerit A. dhe E.2 të cilët gjatë bisedës dëshmitarin dhe tani të akuzuarin L. i kanë kërcënuar me familje duke ia drejtuar armën, ndërsa që të akuzuarit L. ia kanë vënë revolen në gojë, dhe në atë moment dëshmitari është ndjerë shumë i kërcënuar dhe ka filluar të largohet duke i lënë aty A., E.2 dhe L.. Më tutje ka shtuar se para se të takoheshin me tani të ndjerët A. dhe E.2, i akuzuari L. i ka treguar se të njëjtit ja kanë marrur qelsat e makinës së motrës së tij dhe po ashtu në momentin e takimit me të njëjtit i akuzuari L. ka qenë i armatosur, ndërsa që dy ditë më vonë ka marrur vesh për ngjarjen. Gjatë gjithë dëshmisë së tij, dëshmitari ka qenë shumë i shqetësuar, kohë pas kohe ka qajtur duke qenë në një gjendje të ngarkuar emocionale e që sipas tij ka qenë rrjedhojë e asaj që kishte përjetuar në takimin me tani të ndjerët A. dhe E.2.

Nga raporti i ekzaminimit të veturës i dt: 21.09.2016 vërtetohet se është bërë ekzaminimi i veturës së tipit “peugeot206” ngjyrë të kaltërt dhe targa të Republikës së Shqipërisë ... pronë e R.K., e lindur në Sh. të D. Republika e Shqipërisë dhe e martuar në Kosovë dhe njëhherit motra e tani të akuzuarit L.I.. Po ashtu është evidentuar një mostër e marrë e dyshuar substancë narkotike – kanabis sativa e gjetur në maskën e pjesës së përparme të veturës në mes të ndërruesit të shpëjtësive dhe frenit të dorës të kësaj veture. Substanca e paketuar së bashku me paketimin ishte në

peshë 1.5 gram. Të njëjtit raport i është bashkangjitur lista e dëshmive ku është përfshirë lloji i substancës së gjetur dhe vendi i gjetjes së saj dhe po ashtu fotoalbumi i datës së njëjtë në të cilin janë të paraqitura fotografitë e veturës e cila është parkuar në parkingun e automjeteve pranë ndërtesës së N. në P..

Nga skica e vendit të ngjarjes dt:29.08.2016, vërtetohet se në të njëjtën është paraqitur vendi ku ka ndodhur ngjarja duke përshkruar rrugët, pastaj shtëpitë përballë të cilave është zhvilluar e gjithë ngjarja dhe gjësendet të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes të cilat janë ilustruar me numrat dhe është evidentuar ndodhja e tyre në momentin e kqyrjes së vendit të ngjarjes.

Nga raporti i autopsisë i ekspertit mjeko-ligjor F.D. për tani të ndjerin A.G. i dt: 05.09.2016, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se vdekja e të njëjtit ka qenë me dhunë dhe ka ardhur si rrjedhojë e shokut hemorragjik i shkakuar nga gjakderdhja e brendshme. Gjakderdhja e brendshme është rrjedhojë këputjesh të eneve të gjakut (venës iliake të jashtme dhe të brendshme dhe këputjes së pjesëshme të arteriës iliake të jashtme), të shoqëruar me dëmtim të zorrëve si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hedhur nga ana e zjarrit. Dëmtimet e përshkruara sin ë pikën 1 të pjesës së ekspertizës ku janë përshkruar dëmtimet e jashtme paraqesin vrimën hyrëse dhe kanal, ndërsa që dëmtimet e përshkruara në pikën 2 të pjesës përshkruese të ekspertizës paraqesin vrimën hyrëse-tejshkuese, kanal dhe vrimën dalëse të shkakuara nga predhat e hedhura nga arma e zjarrit. Plagët e përshkruara në nr. 3 të dëmtimeve të jashtme dhe ndryshimet lëkurore të përshkruara në pikën 4 dhe 6 të dëmtieve të jashtme të përshkruara si në ekspertizë paraqesin plagët kirurgjikale-terapeutike dhe vendet e punktimeve gjatë aplikimit terapeutik.

Nga raporti i autopsisë i ekspertit mjeko-ligjor F.D. për tani të ndjerin E.A.2 i dt: 05.09.2016, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se vdekja e të ndjerit E.A.2ka qenë me dhunë dhe ka ardhur si rrjedhojë e shokut hemorragjik të shkaktuar nga gjakderdhja e brendshme. Gjakderdhja e brendshme është rrjedhojë e dëmtimit të mushkrive dhe mëlqisë të shoqëruar me dëmtim të palcës kurrizore, si pasojë e veprimit dinamik të predhave të hedhura nga arma zjarrit. Dëmtimet e përshkruara në nr. 1 dhe 2 të pjesës përshkruese të autopsisë lidhur me dëmtimet e jashtme paraqesin vrimat hyrëse dhe tejshkuese, kanalet dhe vrimat dalëse të shkaktuara nga predhat e hedhura nga arma e zjarrit. Plaga e përshkruara me nr. 3 të dëmtimeve të jashtme si në pjesën përshkruese të kësaj autopsie paraqet plagën kirurgjikale terapeutike.

Nga raporti i autopsisë i dt: 08.09.2016 për të ndjerin E.A.2vërtetohet se në të njëjtën është kontatuar se trupi i pa jetë është sjellur në sallën e autopsisë i futur në një një qese plastike për barjtjen e kufomave me ngjyrë të bardhë dhe i identifikuar me numër të autopsisë Trupi i pajetë ishte i gjinisë mashkullore me gjatësi ...m. Këtij raporti i është bashkangjitur lista e dëshmive dhe po ashtu fotoalbumi i dt:30.08.2016 në të cilën janë paraqitur fotografitë nga momentet e zhvillimit të autopsisë, duke filluar nga pozicioni i trupit dhe të gjitha veprimet tjera të kryera gjatë këtij procesi.

Nga raporti i autopsisë i dt:08.09.2016 për të ndjerin A.G.vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar trupi i pa jetë është sjellur në sallën e autopsisë i futur në një një qese plastike për barjtjen e kufomave me ngjyrë të bardhë dhe i identifikuar me nr. të autopsisë Të njëjtit i është bashkangjitur lista e dëshmive në të cilën është evidentuar një predhë fisheku e cila është gjetur në trupin e pajetë të A.G., gjegjësisht në regjionin e legenit të trupit. Po ashtu të njëjtit I është bashkangjitur edhe fotoalbumi i dt: 30.08.2016 në të cilin janë paraqitur fotorafitë e marrura gjatë procesit të kryerjes së autopsisë.

Nga raporti informues i dt:15.11.2016 vërtetohet se gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes nga njësia e forenzikës rajonale janë gjetur dhe konfiskuar si provë fizike gëzhoja, predha, telefon, shkrepës dhe shishe plastike si dhe dëshmitë tjerra që janë të evidentuara në raportin e njësies së forenzikës rajonale.

Nga fotoalbumi i dt:29.08.2016 vërtetohet se në të njëjtin janë paraqitur fotografitë nga vendi ku ka ndodhur ngjarja në ditën kritike, në kryqëzimin e rrugës “H.J.” në rrugën “G.M.” në afërsi të parkut të qytetit. Më tutje në fotografitë në kuadër të albumit, fotografinë nr. 8 është paraqitur motori, disa gurë të cilët gjenden afër tij, pastaj njolla gjaku, një telefon, një shkrepës, një këpucë dhe gëzhoja të predhave të hedhura nga arma e zjarrit, një zingjir, një shisheë ujë dhe gjësende tjera të evidentuara si në fotografitë e fotoalbumit.

Nga raporti i ekspertimit i dt: 10.10.2016 i Agjencisë së Kosovës për forenzikë konstatohet se në të njëjtën është evidentuar se nga dëshmitë e dorëzuara VN#3,VN#7,VN#8, VN#11, VN#12, VN#15 janë 6 gëzhoja të cilat janë pjesë e fishekëve të kalibrit 9x19 mm. Ato janë shkreputur nga e njëjta armë me kalibër të njëjtë 9x19 mm të llojit pistoletë. Dëshmitë e dorëzuara VN#13, VN#16 dhe AG#2 janë 3 plumba të dëmtuar të cilët janë pjesë e fishekëve të kalibrit 9x19mm. Ata kanë vetëm nga 3 palë vijaska të padëmtuara. Identifikimi i tyre nëse janë shkrepur nga e njëjta armë nuk ka qenë i mundur për shkak se asnjëri nuk i ka komplet gjashtë parë shenja të vjaskave të padëmtuara. Identifikimi i tyre mund të bëhet vetëm në rast se gjendet arma e dyshuar dhe sigurohen plumba me komplet shenjat e vjaskave.

Nga raporti informues i dt: 11.01.2017, vërtetohet se të njëjtit i është bashkangjitur raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për forenzikë – Sektori i ADN-së dhe serologjisë i dt: 29.12.2016 në të cilin janë përshkruar dëshmitë të cilat janë marrur e që janë sin ë vijim: VN#5.1-1 tampon me njollë të kuqe i marrur në rrugën “H.J.” në P., VN#10.1- 1 tampon me njollë të kuqe, VN#14- 1 shishe ujë e mbushur me në sasi uji e marrur në rrugën “H.J.”, ...- mostër standarde e gjakut e marrur nga E.A.2dhe MA16-222- mostër standarde e gjakut e marrur nga A.G.. Më pastaj në mendimin përfundimtar është konstatuar se nga dëshmia ... është fituar profili i ADN-së së E.A.2. Nga dëshmitë VN#5.1 dhe VN#10.1 është fituar një profil i njëjtë i ADN-së, I cili profil përputhet me profilin e ADN-së E.A.2, kështu që E.A.2nuk mund të përjashtohet si kontribues i ADN-së në këto 2 dëshmi, ndërsa gjasa e paraqitjes së

këtij profili në populacion është 1 në 1.03 trilion njerëz. Nga dëshmia ... është fituar profili i pjesërishëm i ADN-së së A.G. si rrjedhojë e kualitetit të dobët të mostrës.

Nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve i dt: 22.09.2016 vërtetohet që R.K. i është kthyer vetura tipit “Peugeot 206” ngjyrë të kaltërt dhe targa të Republikës së Shqipërisë ... me nr. serik VF32HNFUF41623966, leja e qarkullimit me nr. seri ... dhe çelsi i veturës.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt:(05.09.2016) vërtetohet se në të njëjtin janë të përshkruara dëshmitë e gjetura si: VN#1 – motor skuter me ngjyrë të bardhë me të kuqe, i cili ishte në pozitën e parkimit, çelsin e kishte në mekanizmin e ndezjes dhe dritat sinjalizuese të aktivizuara, i gjetur në rrugën “H.J.”. Sipas hetuesve motori në momentin kritik ka qenë i rrëzuar por ishte ngritur nga një qytetar gjatë dhënies së ndihmës viktimave, VN#1.1 dhe VN#1.2 –mostra të marrura me tampon të zhytur në ujë të distiluar në dorën e djathtë dhe të majtë të skuterit, VN#2 – atlete e këmbës së djathtë me nr. ... me ngjyrë të kaltërt me mbishkrim “N.” dhe “J. d. i.”, kjo dëshmi ishte në rrugën “H.J.”, në anën e djathtë të rrotës së parë të motorit skuter, VN#3 është evidentuar një gëzhgjë fisheku me mbishkrim në bazë “SUMBRO 9mm LUGER”, VN#4 është evidentuar një telefon Iphone me ngjyrë të zezë, VN#4.1 është evidentuar një shkrep mekanike me ngjyrë të kaltërt me mbishkrim “CRIKET”, VN#5 është evidentuar pellgu I gjakut të mundshëm i cili kishte përfshirë sipërfaqen e trotuarit 0,65cm x 0,35cm, VN#5.1 mostër e marrë me tampon higjienik të zhytur në ujë të distiluar e marrë në pellgune gjakut të mundshëm të evidentuar me VN#5, VN#6 janë evidentuar një palë papuqe me ngjyrë të zezë dhe të gjelbërt e mbishkrim “R. S. ...”, VN#7, VN#8, VN#11, VN#12, VN#15 janë gëzhgoja fisheku me mbishkrim në bazë “SUMBRO 9mm LUGER”, VN#9 është evidentuar një zingjir i qafës i këputur me ngjyrë të verdhë, VN#10 është evidentuar një pellg i gjakut të mundshëm i cili ishte në mes të rrugës, VN#10.1 – mostër e marrur me tampon higjienik e zhytur në ujë të distiluar në pellgun e gjakut të mundshëm të evidentuar në VN#10 , VN#13 dhe VN#16 janë evidentuar predha fisheku, VN#14 është evidentuar një shishe plastike 0.5L me mbishkrim “Ujë natyral i A.” i mbushur gjysmë, VN#17, VN#18 dhe VN#19 janë evidentuar një dëmtim, fragmente metalike brenda lokalit dhe dëmtim i pjesës metalike të dritares të shtëpisë së H.J.1 në P., F#1 janë evidentuar gjurmët latente të nxitura në pluhur të zi të thjeshtë të cilat janë tërhequr me foli xhelatinoze dhe janë vendosur në bazë të bardhë, të gjithë këto të gjendura rrugën “H.J.” përball shtëpisë së H.J.1. Ndërsa që lidhur me rrobat e viktimave janë evidentuar me sa vijon: AG#3 – një palë pantolona me ngjyrë të zezë të firmës “L.” me rryp të zi të cilat i kishte pasur veshur i ndjeri A.G., AG#3.1 – një sasi e substancës së dyshuar narkotike me peshë 1.0 gram e cila ishte në xhepin e vogël të anës së djathtë të pantolonve të evidentuar me AG#3, AG#3.2 – një shkrep me ngjyrë të kuqe, një moneshë metalike 0.50 euro dhe pesë monedha 0,20, AG#4 një fanellë me ngjyrë të hirit dhe të bardhë, AG#5 – një fanellë me mëngë të shkurta me

ngjyrë krem me mbishkrim në pjesën e përparme “E. M.” dhe AG#6 – një atlete sportive me ngjyrë të kaltërt me mbishkrimin “N.” dhe dy qorapë me ngjyrë të zezë. Nga lista e dëshmime nr.rast.2016-AB-2766, e dt:05.09.2016 vërtetohet se në të njëjtën janë evidentuar dëshmitë të cilat janë gjendur në vendin e ngjarjes .

Nga fotoalbumi i dt:29.08.2016 vërtetohet se në të njëjtin janë paraqitur pamje të jashtme të objektit banesor “S.” në rrugën “M.K.” në P., pastaj pamje të brendshme nga banesa nr. ... e cila gjendet në katin e ... të objektit banesor, në të cilat shihet valigjja e tani të akuzuarit L., gjësendet brenda saj, ndër të cilat edhe një substancë e dyshuar narkotike në peshë prej 7.3 gram.

Nga raporti plotësues i dt.20.11.2017 vërtetohet se në të njëjtën është konstatuar se pas kryerjes së veprës penale i akuzuari është larguar nga vendi i ngjarjes për një kohë ka qenë në arrati ndërsa që më dt:19.11.2017 është dorëzuar në stacionin policor në P..

CD-videoincizimi i dt.29.08.2016 vërtetohet se fillimisht në vendin e ngjarjes paraqitet tani i akuzuari L. i cili pasi që qëndron për një kohe rreth 5 minuta para ngjarjes kritike, here herë duke lëvizur dhe në dorë mbanë një shishe ujit, për një moment derisa kalon rrugën, kthehet me fytyrë nga drejtimi nga i cili me motor janë duke ardhur tani të ndjerët E.2 dhe A. me motor, dhe del në trotuarin nga parku, dhe derisa është i kthyer me shpin nga rruga nga e cila vijn tani të ndjerit E.2 dhe A. me motor dhe pasi që afrohen afër vendit ku ishte duke qëndruar i akuzuari L., e ndalin motorin dhe tani i ndjeri E.2 i cili ishte ulur në pjesën pasme të motorit fillon të zbraz nga motori dhe furishëm nisat në drejtim të tani të akuzuarit L. i cili në ato çaste e hedh shishen e ujit dhe me dorën e djathtë nxjerr revolën dhe fillon të shtënë në drejtim të tani të ndjerëve, ashtu që fillimisht shtënë në tani të ndjerin E.2, i cili duke tentuar të largohet përplasat me motorin dhe po ashtu tani të ndjerin A., të cilin gjithashtu e qëllon me ç’rast të njëjtit shihen të shtrirë në tokë, afër njëri-tjetrit pranë trotuarit, ndërsa që i akuzuari L. fillon të largohet duke vrapuar nga vendi i ngjarjes, ndërkohë që paraqiten disa qytetar të cilët ndalin një vetur taksi derisa është duke kaluar aty pranë dhe me ndihmën e personave të pranishëm të njëjtit bartën me veturë për tu dërguar në qendrën klinike universitare.

I akuzuari L.I. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se e gjithë ngjarja ka filluar pasi që personi me emrin G., tani të ndjerit E.2 i’a ka pasur borxh 1300 euro për shkak të një sasive droge që kanë shkëmbyer mes tyre gjegjësisht G. ia ka shitur drogën E.2 ndërsa i njëjti i’a ka kthyer për shkak cilësisë së dobët të drogës, ndërkaq që G. i ka thënë E.2 përmes telefonit se parat ia kam dhënë L. pasi që kur i aka sjellur të njëjtat tani i ndjeri E.2 nuk ka qenë aty, dhe kjo ka ndodhur rreth një muaji para se të ndodh rasti kur tani i ndjeri E.2 e kishte takuar tani të akuzuarin L. te parku i qytetit, ku i kishtë kërkuar parat që sipas tani të ndjerit E.2, G. ia kishte dhënë të akuzuarit L., ndërsa që ai ishte përgjigjur se G. nuk i aka dhënë parat pastaj E.2 ka filluar ta shaj e ta kërcënoj dhe e ka nxjerr revolën dhe i aka drejtuar në gjoks duke i

thënë “Unë ta mbushi gjoksin me plumba” dhe e ka goditur 2 herë në fytyrë. Më tutje ka shtuar se pas kësaj ngjarje është larguar për në Shqipëri dhe pastaj përsëri është kthyer në P. për të qëndruar me motrën e tij pasi që burri i të njëjtës ka qenë në Z., dhe si rrjedhojë e problemeve që ka pasur me tani të ndjerët kur është kthyer nga Shqipëria ka marrur një revole me vete dhe deri sat ë nesermen e ardhjes nga Shqipëria ka qenë duke qëndruar tek parku i qytetit e ka thirrur tani i ndjeri E.2 dhe i ka thënë që të shkojë te shtëpia e tij, ta marrë veturën për të pirë një kafe dhe se në momentin kur ka shkuar te shtëpia e të njëjtit, i ka thënë që te hyp në veturë mirëpo tani i ndjeri E.2 I kishte thënë që të dal pasi që ka për të biseduar diçka me të dhe në momentin kur ka dalur E.2i ia kishte marrur qelsat e veturës kurse tani i ndjeri A. kishte nxjerrë revolën, an ipse i’u kishte thënë që vetura është e motrës së tij dhe se ajo nuk ka faj për këtë situatë, mirëpo që tani i ndjeri E.2 i kishte thënë që duhet t’ia jap parat pasi që G. nuk iu ishte përgjigjur në telefon, dhe përderisa i njëjti i ishte afruar veturës që të largohet, tani të ndjerët E.2 dhe A. dhe dëshmitari E.3 e kanë tërhequr dhe kanë filluar ta godasin, mirëpo edhe pse i njëjti e ka pasur revolën me vete, të njëjtën nuk e ka përdorur dhe në ato momente në ballkon kishte dalur nëna e E.2 e cila iu kishte thënë “moni djalin se gjynah”, mirëpo tani i ndjeri E.2 e kishte ofenduar të njëjtën dhe i kishte thënë se nuk i dinë punët e tyre. Më tutje ka shtuar se pasi që i është marrë vetura ka shkuar tek parku i qytetit dhe ka thirrur shokun e tij, tani dëshmitarin E.H. nga Shqipëria dhe pasi që e ka njoftuar për ngjarjen ka kërkuar ndihmë nga i njëjti të i rregullojë raportet me tani të ndjerit E.2 dhe A. dhe pasi që i njëjti kishte arritur në Kosovë janë takuar me tani të ndjerët te lagjia e E.2 dhe ka kërkuar kthimin e veturës së marrur, mirëpo tani i ndjeri E.2 i ka thënë se i do parat ndërsa që tani i ndjeri A. ka nxjerrur revolën të cilën i’u ka vënë në gojë duke i thënë se nëse e njofton policinë do të vrasim ty me gjithë motër. Po ashtu ka shtuar se edhe pas këtij takimi kanë vazhduar presionet në drejtim të të njëjtit dhe ditën kritike para momentit kritik ka takuar 2 herë tani dëshmitarin E.3, ashtu që fillimisht i njëjti ka qenë vetëm dhe në atë rast të akuzuarit i ka thënë se “ose ki me mi dhon parat, ose ka me të mbyt krejt” dhe me atë rast e ka goditur 2 herë me shuplak në fytyrë, ndërsa që herën e dytë dëshmitari E.3 ka qenë bashkë me tani dëshmitarin M. dhe në atë rast i ka thënë “shko merri mangupat e Shqipërisë dhe hajde përplasemi”. Më tutje ka shtuar se pas takimit me E.3 e ka thirrur në telefon tani të ndjerin E.2 dhe i ka thënë “pse me mrreh E.3 prap, a nuk u knaqet që më rrahët deri tash”, ndërsa që tani ndjeri E.2 I është përgjigjur “hajt se un vi në park, aty pritëm” dhe derisa i akuzuari ka qenë duke qëndruar para parkut duke pritur të njëjtit për të biseduar në lidhje me problemet që kishin, pas gjysmë ore, kanë ardhur me motor tani të ndjerët dhe për një moment derisa i njëjti është kthyer me shpinë dhe ka dashur të hyjë në kafiteri për të biseduar, ndërsa që E.2 ka zbritur nga motorri është nisur në drejtim të tij duke i thënë “kemi ardhur me ta hek kryt” ndërsa që i akuzuari e ka nxjerrë revolen dhe ka shtënë në drejtim të tyre dhe arsyeja pse ka shtënë ka qenë për shkak të fjalëve që ia kishte thënë E.2 në atë moment dhe po ashtu faktit që ka qenë i rrahur nga të njëjtit më

herët. Po ashtu ka shtuar se pasi që ka ndodhur ngjarja është nisur në drejtim të Republikës së Shqipërisë, ku pasi ka qëndrar rreth 23 ditë ka shkuar në I. ku pas 2 muajve se ka tentuar të bëjë vetvrasje duke u hedhur nga kati i pestë, ka qëndruar 5 muaj në spital nga të cilat 4 muaj në komë dhe pastaj ka vendosur të dorëzohet.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit E.A.1 dhe të njëjtës i'a ka falur besimin vetëm lidhur me faktin se si rrjedhojë e borxhit të pretenduar se i akuzuari L. i ka pasur tani të ndjerit E.2, i njëjti ja kishte marrur veturën derisa i akuzuari të ja kthente borxhin, pasi që ky pohim është në përputhje edhe me dëshminë e dëshmitarit E.3 por edhe provën materiale siç është vërtetimi mbi mbi kthimin e sendeve i dt: 22.09.2016 me të cilin vërtetohet që vetura "Peugeot 206" i është kthyer motrës së tani të akuzuarit, përkatësisht pronares R.K., ndërsa që pjesë tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari nuk ja ka falë besimin, pasi që ky dëshmitar për të gjitha rrethanat relevante ka deklaruar se ka dëgjuar nga persona tjerë, të cilët i kanë dhënë përshkrime përkatëse se si ka ndodhur ngjarja qoftë në ditën kritike, qoftë situatës paraprake që i ka paraprirë ngjarjes e që pohimet e këtyre personave janë në kundërshtim me njëra-tjetrën e po ashtu me provat materiale të administruara në këtë çështje penale, siç është deklarata e dëshmitarës Sh.F. e cila ka pretenduar se kinse ka qenë e pranishme në momentin kritik e po ashtu se me të njëjtën është takuar në QKUK, ndërsa që nga videoincizimi i administruar në cilësi të provës materiale vërtetohet se e njëjta nuk ka qenë fare e pranishme në ditën kritike në vendin ku ka ndodhur ngjarja a po të ketë qenë në veturën me të cilën tani të ndjerët janë dërguar në QKUK dhe po ashtu ky dëshmitar një rrethanë të tillë nuk e ka përmendur në deklaratën e dhënë në polici me dt:08.09.2016 ani pse nisur nga afërsia e ngjarjes, pra kujtesën e ka pasur shumë me të freskët është dashur ta përmendur patjetër, nisur edhe nga rëndësia e pohimeve që pretendon se i janë thënë nga tani dëshmitaria Sh.F.. Pra gjykata e vleron jo relevante dëshminë e këtij dëshmitari pasi që i njëjti e mbështetë në atë që i është thënë nga të tjerët, gjegjësisht tani dëshmitarët Sh.F. dhe E.A.3, e të cilët persona kjo gjykatë i ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarve gjatë shqyrtimit gjyqësor, e të cilave dëshmi nuk u ka fal besimin pasi që dëshmitë e këtyre dëshmitarve janë në kontradiktë me vetvetën dhe me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit S.G. dhe të njëjtës nuk i'a fal besimin pasi që i njëjti për të gjitha rrethanat ka dëgjuar përmes të tjerëve, të cilët i'a kanë përshkruar ngjarjen dhe po ashtu si ka rrjedhë situata paraprakisht, ndërsa që lidhur me qëndrimin se vrasja ka qenë e planifikuar nga tani i akuzuari L. dhe se atë e ka ndihmuar një person i tretë, gjykata nuk ka administruar asnjë provë gjatë shqyrtimit gjyqësor në drejtim të vërtetimit të një pretendimi të tillë, ndërsa që këto pohime më shumë janë prodhim i një pamundësie të natyrshme për ta pranuar një fakt tragjik se djali i tij, tani i ndjeri A. nuk jeton më.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit E.A.3 dhe të njëjtës pjesërisht i'a ka falur besimin dhe atë vetëm sa i përket rrethanës se në ditën kritike para se të ndodh ngjarja, vërtet ky dëshmitar derisa ishte në shoqërim të dëshmitarit M.R. e kanë takuar tani të akuzuarin L.I. dhe ka biseduar me të njëjtin dhe se po ashtu para se tani të ndjerët të nisen me motor, ky dëshmitar bashkë me dëshmitarin M. dhe tani të ndjerët E.2 dhe A. kanë qenë së bashku në kafiterinë "E.4" dhe se po ashtu një ditë para ngjarjes kritike, të akuzuarit L. i është marrur vetura nga tani i ndjeri E.2, përtej fakti se ky dëshmitar ka pretenduar se i akuzuari L. i'a ka dhënë në vullnet, mirëpo që kjo bie në kundërshtim me vetë logjikën e shpjegimit të ngjarjes nga vetë ky dëshmitar, duke qenë se në njëren anë ka pohuar se i akuzuari L. ka refuzuar ta paguaj borxhin për çka edhe kur e ka takuar në ditën kritike ky dëshmitar ka pohuar se i ka thënë se i ka kërkuar të akuzuarit L. kthimin e borxhit, ndërsa që në anën tjetër pohon se veturën i akuzuari L. tani të ndjerit E.2 ja ka dhënë në vullnet. Ndërsa që po ashtu, sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata nuk i'a ka falur besimin pasi që të dy këto rrethana ka kontradikta mes këtyre dy dëshmitarve sa i përket përmbajtjes së këtyre rrethaneve ashtu që, deri sa ky dëshmitar ka pohuar se me rastin e takimit me të akuzuarin L. e ka pyetur lidhur me borxhin prej 1300 euro dhe ka folur me tone të larta, dëshmitari M. nuk i përmend asnjëherë nga këto rrethana, e po ashtu edhe sa i përket qëndrimit në kafiteri me tani të ndjerët E.2 dhe A., përtej fakti se e kanë pohuar se i ndjeri E.2 ka kontaktuar me të akuzuarin L., kanë pohuar ndryshe sa i përket përmbajtjes së bisedës në mes tyre ashtu që derisa dëshmitari E.3 pohon se tani i ndjeri E.2 i'u kishte thënë se L. i ka kërkuar që të takohen te parku, dëshmitari M. pohon se i akuzuari L. i kishte kërkuar tani të ndjerit E.2 të takohen te parku i qytetit për t'ia dhënë parat që i kishte borxh. Po ashtu gjykata dëshminë e këtij dëshmitari e ka gjetur në kundërshtim me vetë vetën edhe sa i përket rrethanës së njohjes me të akuzuarin L., ashtu që fillimisht ka deklaruar se e ka pa të akuzuarin L. duke u sjellur në lagjen e tyre, ndërsa që me vonë gjatë dëshmisë ka deklaruar se që prej momentit kur e ka kuptuar se E.2 i ka dhënë para borxh L. është interesuar për faktin se kush është L., ku banon, çfarë veture vozitë dhe me kënd rri. Po ashtu edhe sa i përket destinimit të parave për të cilat ka deklaruar se i ndjeri E.2 ja ka dhënë të akuzuarit L., në deklaratën e dhënë në polici me dt:08.09.2016, nuk ka përmendur rrethanën se këto para i ndjeri E.2 i kishte për të hapur një Call Center, e që këtë rrethanë e ka pretenduar në shqyrtimin gjyqësor e se po ashtu edhe dëshmitari E.A.1 dhe S.A. të njëjtën rrethanë e kanë pohuar në shqyrtimin gjyqësor mirëpo dëshmitari E.A.1, sikurse dëshmitari E.3 një rrethanë të tillë nuk e kanë përmendur në procedurën paraprake, ani pse nisur nga fakti se të njëjtat deklarata i kanë dhënë menjëherë pas ngjarjes kritike kur kujtesën e kanë pasur më të freskët e sigurisht është dashur të i'u kujtohet një rrethanë e tillë, mirëpo që quditërisht që të dy këta dëshmitarë këtë rrethanë e kanë përmendur në seancën e shqyrtimit gjyqësor duke përfshirë këtu edhe dëshmitarën S.A. e cila nuk ka dhënë deklaratë në procedurën paraprake lidhur me këtë çështje penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarës Sh.F., të cilës dëshmi nuk i'a ka fal besimin pasi që e njëjta nuk nuk është e sinqertë, reale e objektive pasi që është në kundërshtim edhe me provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kjo dëshmitare në dëshminë e saj ka pretenduar se ka qenë e pranishme në vendin e ngjarjes, para se të ndodh rasti, në kohën kur ka ndodhur rasti dhe po ashtu pasi që ka ndodhur rasti me ç'rast ka ndihmuar që tani të ndjerët të transportohen në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës, mirëpo që nga videoincizimi i administruar në cilësinë e provës materiale në të cilën paraqitet momentit kritike të zhvillimit të ngjarjes, e po ashtu edhe momenti i ofrimit të ndihmës, e në të cilat pamje kjo dëshmitare nuk paraqitet fare, pra nuk ka qenë fare e pranishme, qoftë para se të ndodh rasti siç ka përshkruar që ka qenë tek kontinierët e po ashtu nuk ka qenë as në momentin kritik dhe po ashtu as kur tani të ndjerët janë vendosur në një makinë dhe janë dërguar në QKUK, andaj e gjithë dëshmia e kësaj dëshmitare është e përpunuar, dhe si e tillë jo vetëm në kundërshtim me provat materiale, mirëpo e mbushur edhe me element të tillë të panatyrshëm në ngjarje të tilla sa që e shkatërroj çfardo mundësie që e njëjta të vlerësohet si e besueshme e lëre më e bindshme, ashtu që e njëjta pretendon se derisa ka qenë në veturen me të cilën janë bartur tani të ndjerët, ka zhvilluar bisedë me të njëjtit e të cilët edhe e kanë falenderuar për ndihmën, me atë rast edhe i ka pyetur të ndjerët se “A e kishte emrin I. apo si quhej personi që i'u qëlluj me armë?!” një pyetje e tillë në ato moment, është e palogjikshme dhe e panatyrshme, ndërsa që mungesa e dëshmitarës në gjithë ngjarjen e bënë të pamundshme që dëshmitaria të ua ketë bërë tani të ndjerëve një pyetje të tillë. Mirëpo kjo dëshmitare, për ta bërë të besueshme dëshminë e saj, përshkruan edhe elementet që në të vërtetë e shkatërrojnë në tërësi dëshminë e të njëjtës, siç janë kur pohon se pasi që tani personi fillimisht ka gjuajtur në të ndjerët është kthyer dhe përsëri ka shtënë në drejtim të të njëjtëve, e që tani dëshmitarja e përshkruan si një person i cili ka vepruar shumë gjakftohët mirëpo që nuk ka treguar se mbi të cilat premise arriti në këtë konkluzion se i akuzuari ka vepruar “shumë gjakftohët”, e po ashtu edhe pohimi i kësaj dëshmitarie se në momentin kur ka zbritur nga motori tani i ndjeri E.2 i është drejtuar me fjalët të “lutem mos shtënë me armë” gje që nga vetë mënyra e levizjes së tani të ndjerit E.2, shihet qart se i njëjti nuk ka mundur të thotë fjalë të tilla, mirëpo që të njëjtat i pohon kjo dëshmitare, e me qëllim të rëndimit të pozitës së tani të akuzuarit në procedurë, e që kjo rezulton nga fakti se deri sa në njërin anë pretendon se tani i akuzuari L. ka qenë gjakftohët në veprimet e tij, tani të ndjerët edhe janë lutur që të mos qëllojë në drejtim të tyre.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit M.R. dhe të njëjtës pjesërisht i'a ka falur besimin dhe atë vetëm sa i përket rrethanës se vërtetë ky dëshmitar derisa ishte në shoqërim të dëshmitarit E.A.3 e kanë takuar tani të akuzuarin L.I. dhe se po ashtu para se tani të ndjerët të nisen me motor, ky dëshmitar bashkë me dëshmitarin E.3 dhe tani të ndjerët E.2 dhe A. kanë qenë së bashku në kafiterinë “E.4”, ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari gjykata nuk i'a ka falur besimin

pasi që sa i përket përmbajtjes së këtyre rrethaneve dëshmia e të njëjtit është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit E.A.3, por edhe dinamikën e ngjarjes në ditën kritike, ashtu që, deri sa ky dëshmitar ka pohuar se me rastin e takimit me të akuzuarin L. tani dëshmitari E.3 ka biseduar për borxhin lidhur me një veturë dhe nuk ka përmendur se është biseduar me ton të lartë ndërsa që dëshmitari E.3 nuk ka përmendur asnjëherë se në bisedën me tani të akuzuarin është përmendur vetura, dhe se gjatë bisedës me të akuzuarin L., i njëjti ka folur me tone të larta dhe po ashtu edhe sa i përket rrethanes së bisedës telefonike të tani të ndjerit E.2 me të akuzuarin L., deri sa ky dëshmitar pohon i ndjeri E.2 i'u ka thënë se tani i akuzuari L. ka kërkuar që të takohen tek parku për t'ia dhënë parat, dëshmitari E.3 ka pohuar se tani i ndjeri E.2 i'u kishte thënë se L. i ka kërkuar që të takohen te parku dhe nuk i ka përmendur parat siç pohon ky dëshmitar ani pse ky dëshmitarë thotë se lidhur me këtë E.2 i ka treguar pikërisht dëshmitarit E.3 deri sa ky ishte i pranishëm aty.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarës S.A. dhe të njëjtës i'a ka falur besimin vetëm lidhur me rrethanën që ka të bëjë me borxhin që tani i ndjeri E.2 pretendon se i'a ka pasur tani i akuzuari L., ndërsa që pjesës tjetër të dëshmisë së kësaj dëshmitare gjyka nuk i'a ka falur besimin mirëpo të njëjtëve ka gjetur jorelevante pasi që e njëjta është dëshmi e përpunuar rreth pohimit të një fakti se parat e borxhit të pretenduar tani i ndjeri E.2 ka pasur ti investojë në hapjen e një call center, mirëpo që dy dëshmitarët tjerë E.3 dhe E.A.1, këtë rrethanë e kanë pohuar vetëm në dëshmitë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, mirëpo jo edhe në deklaratat që kanë dhënë në procedurën paraprake, deklarata këto të dhëna menjëherë pasi që ka ndodhur ngjarja e që duke qenë se kujtesën e kanë pasur më të freskët dhe peshën e kësaj rrethane në gjithë këtë ngjarje tragjike është dashur që patjetër të i'u kujtohet e njëjta, mirëpo që quditërisht asnjëri prej tyre nuk e ka përmendur fare të njëjtën.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit E.H., dëshmi të cilës i'a ka falur besimin pasi që të njëjtën e ka gjetur të sinqertë, reale dhe objektive e nga e cila vërtetohet qartë fakti se ngjarjes kritike i ka paraprirë mosmarrëveshja lidhur me borxhin të cilin i akuzuari L. nuk e ka pranuar si borxh të tij dhe se pikërisht për të ardhur deri te një zgjidhje lidhur me këtë mosmarrëveshje i akuzuari L. e ka thirrur tani dëshmitarin E.5 që së bashku me të njëjtit të bisedojë me tani të ndjerin E.2, mirëpo siç është vërtetuar edhe nga ky dëshmitari i akuzuari L. ishte kërcënuar nga tani i ndjerët E.2 dhe A. se duhet ta kthejë borxhin me çdo kusht, duke mos pranuar të bisedojë fare lidhur me këtë çështje, deri sa që tani të ndjerët E.2 dhe A. kanë qenë të armatosur, e që kjo është në përputhje edhe me mbrojtjen e të akuzuarit, mirëpo edhe me vet reagimin e të njëjtit në momentin kritik nisur nga mënyra se si tani i ndjeri E.2 i është drejtuar të akuzuarit duke u nisur furishëm drejtë tij dhe po ashtu reagimin e tani të akuzuarit L. i cili menjëherë e ka nxjerrur revolën dhe ka filluar të qëllojë në drejtim të të njëjtëve duke qenë se më herët ishte kërcënuar nga të njëjtit, të cilët edhe ishin të armatosur.

Gjykata ka vlerësuar vërtetimin mbi kthimin e sendeve i dt: 22.09.2016 dhe raportin e ekzaminimit të veturës të dt: 21.09.2016 dhe përmes të cilëve ka vërtetuar faktin se vetura e tipit “peugeot206”, ngjyrë të kaltërt me targa të Republikës së Shqipërisë ..., e cila i është marrur të akuzuarit L. një ditë para ngjarjes kritike ka qenë në pronësi të motrës së tij R.K., duke vërtetuar faktin se të akuzuarit L., vetura i është marrur pa vullnetin e tij me rastin kur i akuzuari L. kishte shkuar te tani i ndjeri E.2 për të biseduar lidhur me borxhin, pasi që një rrethanë e tillë vërtetohet jo vetëm nga sjelljet e akuzuarit L. i cili nuk kishte se si t’ia jepte për ta mbajtur tani të ndjerit E.2, por po ashtu edhe nga fakti se vetura nuk ka qenë fare e të akuzuarit L. por e motrës së tij, e që pikërisht kjo rrethanë edhe e ka rënduar situatën ashtu që vetëm një ditë pasi që ka ndodhur marrja e veturës ka ardhur deri te ngjarja kritike i privimit nga jeta të tani të ndjerëve E.2 dhe A.. Ndërsa që nga raporti i ekzaminimit të veturës vërtetohet se me rastin e ekzaminimit të të njëjtës janë gjetur substanca narkotike me paketim në peshë prej 1.5 gram.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportet e autopsisë së dt: 05.09.2016 dhe 08.09.2016 për të ndjerët E.A.2 dhe A.G. dhe fotoalbumin e dt:30.08.2016 lidhur me shkakun e vdekjes së të njëjtëve, e nga të cilat raporte vërtetohet procesi i kryerjes së autopsisë për tani të ndjerët dhe shkakun e vdekjes së të njëjtëve, ku konstatohet se vdekja e të njëjtëve ka qenë me dhunë dhe ka ardhur si rrjedhojë e shokut hemorragjik i shkaktuar nga gjakderdhja e brendshme.

Gjykata ka vlerësuar raportin informues të dt: 15.11.2016, fotoalbumin e dt: 29.08.2016, skica e vendit të ngjarjes dt:29.08.2016, raportin e ekspertimit të dt:10.10.2016, raportin informues i dt: 11.01.2017, lista e dëshmitëve nr.rast.2016-AB-2766 e dt:05.09.2016, raporti plotësues i dt.20.11.2017, raportin e kqyrjes së vendit të ngjarjes të dt: 05.09.2016 e nga të cilat ka vërtetuar vendin ku ka ndodhur ngjarja, pastaj provat që janë gjetur në vendin e ngjarjes, kthimi i sendeve të cilat nuk kanë qenë të lidhura me veprën penale, dhe po ashtu përshkrimi i vendit të ngjarjes në ditë kritike, e nga të cilat prova vërtetohet po ashtu gjendja e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata ka vlerësuar CD-videoincizimin të dt.29.08.2016 nga e cili ka vërtetuar bindshëm faktin se tani i akuzuari derisa ishte duke qëndruar kanë ardhur tani të ndjerët me motor, dhe se në momentin kritik derisa tani i akuzuari L. ka qenë duke kaluar rrugën i ka parë duke ardhur tani të ndjerët me motor e që vërtetohet edhe nga fakti se tani i ndjeri A. e ka të ngritur dorën në drejtim horizontal në momentin kur i akuzuari kalon rrugën dhe tani të ndjerët janë duke ardhur në drejtim të tij, mirëpo i akuzuari bën sikur nuk i ka vërejtur të njëjtët dhe kthehet me shpinë nga tani të ndjerët, ndërsa që pasi ka ndalur motorin me vrull afër të akuzuarit L. tani i ndjeri E.2 ka filluar të zbres nga motori dhe furishëm është drejtuar në drejtim të tani të akuzuarit të cilit është e qartë se i është drejtuar me fjalë duke qenë se pas këtij momenti i akuzuari kthehet në drejtim të të njëjtët dhe nxjerr pistoletën dhe qëllon në drejtim të

tani të ndjerëve, fillimisht në drejtim të E.2 dhe pastaj edhe A.. Një reagim i tillë i tani të akuzuarit po ashtu vërteton faktin e raporteve të acaruar me tani të ndjerët lidhur me borxhin për të cilin edhe ishte marrur vetura një ditë më herët, fakt ky i pohuar nga i akuzuari L. por edhe dëshmitari E.A.3, mirëpo që në këtë drejtim reagimi i tani të akuzuarit L. është në përputhje edhe me mbrojtjen e paraqitur lidhur me këtë rrethanë se vërtetë para ngjarjes kritike, përveç marrjes së veturës i njëjti edhe ka qenë i kërcënuar nga tani të ndjerët, pasi që në rrethana tjera veprimi i akuzuarit L. është i pashpjegueshëm siç është nxjerrja e revolës dhe qëllimi në drejtim të tani të ndjerëve.

Andaj, gjykata në këtë gjendje të vërtetuar faktike vlerëson se në veprimet e të akuzuarit L.I. manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 179 par 1 nënpar 11 të KPRK-së, pasi që nga të gjitha provat e administruara dhe nga vetë pohimi i të akuzuarit L. është vërtetuar fakti se i njëjti ka privuar nga jeta tani të ndjerët E.2 dhe A., ndërsa që rrethana cilësuese e kësaj vepre penale që ka të bëjë me privimin nga jeta të dy apo më shumë personave është konsumuar duke qenë se tani i akuzuari L. është kryerës i veprës penale, pasojë e të cilës është privimi nga jeta i tani të ndjerëve të lartëcekur.

Në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese rrethana se tani i akuzuari L.I. ka privuar nga jeta tani të ndjerët E.A.2 dhe A.G., me dt: 29.08.2016, rreth orës 11:40 min në P., afër parkut të qytetit, në rrugën "H.J." dhe se po ashtu nuk ka qenë kontestuese rrethana se ndërmjet të akuzuarit L. dhe tani të ndjerëve E.2 dhe A. kishte mosmarrveshje lidhur me një borxh, mirëpo ka qenë kontestuese natyra e raportit në mes të akuzuarit L. në njëren anë dhe tani të ndjerëve E.2 dhe A. në anë tjetër, dhe rrethanave që i kanë paraprir ngjarjes kritike të privimit nga jeta të tani të ndjerët E.A.2 dhe A.G.. Ndërsa që nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike se ngjarjes kritike i ka paraprirë mosmarrëveshja lidhur me ekzistencën e një borxhi, rrethanë kjo që është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit E.A.3, E.A.1, S.A. e po ashtu edhe nga vet pohimi i të akuzuarit L. dhe se lidhur me këtë duke qenë se i akuzuari nuk e ka pranuar këtë borxh për të vetin, një ditë para ngjarjes kritike të njëjtit i është marrur vetura dhe se kjo rrethanë është vërtetuar po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit E.3 i cili pjesërisht e ka pohuar këtë fakt kur ka pohuar faktin se një ditë para ngjarjes kritike veturën e të akuzuarit L. e ka poseduar tani i ndjeri E.2 dhe po ashtu këtë fakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari. Po ashtu se kjo veturë i është marrur deri sa i akuzuari ka qenë tek shtëpia e tani të ndjerit E.2 e që ky fakt po ashtu vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit E.3, ndërsa që marrja e kësaj veture pa vullnetin e të akuzuarit L., vërtetohet nga vet pohimi i këtij të akuzuari por edhe nga rrjedhja logjike e ngjarjeve e që është manifestimi i vazhdueshëm i mospranimit të këtij borxhi nga ana e të akuzuarit dhe që mospranimi i borxhit vërteton faktin po ashtu se vetura e të njëjtit i është marrur jo vetëm në mungesë të vullnetit të të njëjtit por edhe nën kërcënim në momentin kur i akuzuari ka shkuar në shtëpinë e tani të ndjerit E.2

dhe se rrethana se i akuzuari ka qenë i kërcënuar nga tani i ndjeri E.2 vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit E.H. e që është në përputhje edhe me dinamikën e rrethanave që i kanë paraprirë ngjarjës kritike dhe me vet reagimin e të akuzuarit në vet momentin e privimit nga jeta e tani të ndjerëve por edhe veprimet e tani të ndjerit E.2 në momentin kur fillon të zbres nga motori ashtu që furishëm niset në drejtim të akuzuarit L. duke treguar kështu për raportin ndërmjet tyre dhe situatës në të cilën gjendej i akuzuari L. si pasojë e borxhit që i kërkohej të njëjtit e që i akuzuari nuk e pranonte për të vetin.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit L.I., dhe të njëjtën e ka gjetur të bazuar vetëm sa i përket rrethanës se të njëjtit një ditë para ngjarjës kritike i është marrë vetura nga tani i ndjeri E.2 dhe se po ashtu ka qenë i kërcënuar nga i njëjti për kthimin e borxhit që ky i akuzuar nuk e ka pranuar për të tij, ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të mbrojtjes së paraqitur nga i akuzuari dhe mbrojtësja e tij, gjykata të njëjtat i ka gjetur të pabazuara dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe se këtë mbrojtje e vlerëson se është në funksion të shmangies nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën akuzohet, pasi që në rastin konkret në gjendjen faktike të vërtetuar nuk ekzistojnë rrethana për aplikimin e dispozitave që kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit nën kufirin e paraparë me ligj për këtë vepër penale.

Po ashtu nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, pasi që i njëjti nga data e pacaktuar e deri në momentin kritik ka mbajtur në posedim armën me të cilën edhe ka privuar nga jeta tani të ndjerët, të cilën armë i akuzuari ka pohuar se e ka blerë gjatë kohës sa ka qenë në Republikën e Shqipërisë dhe po ashtu edhe para ngjarjës kritike, të njëjtën e ka mbajtur në vazhdimsi.

Me rastin e përcaktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit si rrethanë lehtësuese mori parasysh moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, pra që ngjarjës kritike i ka paraprirë një mosmarrëveshje lidhur me një borxh të cilin i akuzuari nuk e ka pranuar sit ë vetin e që për këtë edhe ka qenë i kërcënuar e po ashtu edhe i është marrë vetura e cila ka qenë në pronësi të motrës së tij, se i akuzuari që nga fillimi i procedurës penale thaujse në tërësi e ka pranuar kryerjen e veprës penale me përjashtim të rrethanave që i kanë paraprirë të njëjtës, sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale meqenëse se gjykata nuk ka administruar të dhëna se i njëjti para kryerjes së kësaj vepre penale apo pasi që ka kryer të njëjtën ka qenë i hetuar, gjykuar apo dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.Ndërsa si rrethanë rëndësuese gjykata ka gjetur shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, moshën e re të tani të ndjerëve A. dhe E.2, dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës

penale familjeve të tani të ndjerëve të cilët janë privuar në mënyrë të përhershme nga prania e më të dashurve të tyre duke shkaktuar dhëmbje të pakompensueshme prindërve të të njëjtëve, andaj duke vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar së dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura dhe për këtë vepër penale është bindur se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarit dhe si e tillë duhet të shërbejë si preventive gjenerale, posaçërisht asaj individuale, tek forcimi i moralit të shoqërisë dhe respektimin e jetës së çdo qytetari.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit mbi dënimin e shqiptuar është marrë konform nenit 83 par 1 të KPRK-së.

Të akuzuarit L.I. i është vazhduar paraburgimi deri në plotëfuqishmëri të këtij aktgjykimi, konform nenin 367 par. 2 lidhur me par 7 të KPPK.

Vendimi që palët e dëmtuara të udhëzohen në kontest civil lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par 2 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kompensimin e viktimave është marrur konform nenit 39 par 3 nënpar 3.2 të Ligjit për kompensimim e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marrur konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.369/17, të dt:05.06.2018

Bashkëpunatori profesional,
Driton Berisha

Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.